



Bashkia Gjirokastër

PROCEDURA E OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË FUSHËS SË FLUTURIMIT GJIROKASTËR

PËRMBAJTJA

TË PËRGJITHSHME	3
0 ADMINISTRIMI	3
0.1 HYRJE	3
0.1.1 Deklarata e përputhshmërisë	3
0.1.2 Deklaratë për Procedurën e operimit dhe mirëmbajtjes së aerodromit fushor të Gjirokastrës	4
0.1.3 Terma dhe përkufizime	5
0.2 SISTEMI I AMENDIMEVE DHE RISHIKIMEVE	6
0.2.1 Detaje të personit përgjegjës për pasqyrimin e rishikimeve dhe amendimeve të procedurës	6
0.2.2 Regjistër i amendimeve dhe rishikimeve	7
0.2.3 Lista e faqeve efektive	7
0.2.4 Lista e shpërndarjes	7
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM	8
1.1 OBJEKTI DHE QËLLIMI I PROCEDURËS	8
1.2 KËRKESAT LIGJORE TË ZBATUESHME	8
A. ORGANIZIMI DHE PËRGJEGJËSITË E AERODROMIT FUSHOR TË GJIROKASTRËS	9
2.1 Detyrimet dhe përgjegjësitë e operatorit të fushës së fluturimit	9
2.2 Pozicionet e ngarkuara me përgjegjësi për sigurinë në operim dhe detyrat përkatëse	11
B. VECORITË E ZONËS SË FLUTURIMIT	11
3. PËRSHKRIMI I FUSHËS SË FLUTURIMIT	11
3.1 PLANI I CILI PARAQET DISTANCËN E FUSHËS SË FLUTURIMIT NGA QYTETI APO ZONA MË E AFËRT E POPULLUAR	11
3.2 KUSHTET E PËRDORIMIT TË FUSHËS SË FLUTURIMIT TË GJIROKASTRËS	12
3.3 PËRSHKRIMI I KARAKTERISTIKAVE FIZIKE TË FUSHËS SË FLUTURIMIT	12
C. PROCEDURAT E OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË FUSHËS SË FLUTURIMIT TË GJIROKASTRËS	13
4.1. Inspektimi i infrastrukturës dhe fasiliteve të fushës së fluturimit	13
4.2. Mirëmbajtja	14
4.3. Procedura për njoftimin e AAC-së për të gjitha ndryshimet dhe regjistrimet e njoftimeve për ndryshime gjatë dhe jashtë orarit normal të operatorit të fushës së fluturimit	14
4.4. Procedurat për lëvizjen, parkimin e mjeteve, dhe aksesimin e zonës së lëvizjes	15
4.5. Plani i emergjencave në aerodrome	15
4.6. Shpëtimi dhe mbrojtja nga zjarri	15
4.7. Inspektimi i mjeteve në zonë të kontrolluar	17
4.8. Procedurat e kontrollit të pengesave	17
4.9. Trajtimi i materialeve të rrezikshme	18

TË PËRGJITHSHME

0 ADMINISTRIMI

0.1 HYRJE

0.1.1 Deklarata e përputhshmërisë

Nënshkrimet e mëposhtme vërtetojnë që kjo procedurë është rishikuar dhe pranuar, dhe tregon se nënshkruesit janë të vetëdijshëm për të gjitha kërkesat që përmban kjo procedurë dhe dedikohen për të siguruar përmbushjen e tyre.

	Përgatitur nga	Miratur nga
Nënshkrimi		
Emri	Aleksandri Pasha	Flamur Golemi
Pozicioni	Menaxher raportues	Kryetar Bashkia Gjirokastrë
Datë	25-10-2024	

0.1.2 Deklaratë për Procedurën e operimit dhe mirëmbajtjes së aerodromit fushor të Gjirokastër

Kjo procedurë përmban të gjithë informacionin e rëndësishëm në lidhje me vendndodhjen e fushës së fluturimit, objektet, shërbimet, pajisjet, procedurat operacionale, menaxhimin dhe mirëmbajtjes, me qëllim funksionimin e sigurt të kësaj fushe fluturimi.

Zbatimi i kërkesave të kësaj procedure ka si qëllim ruajtjen e standardeve dhe operimin e fushës së fluturimit të Gjirokastër në përputhje me kushtet e përcaktuara në Certifikatën e Fushës së Fluturimit.

Procedura e operimit dhe mirëmbajtjes së fushës së fluturimit përshkruan në mënyrë të qartë dhe në formë koncize mënyrën sistematike të operimit të saj, duke demonstruar përkushtimin tonë për të menaxhuar në mënyrë të sigurt dhe efikase fushën e fluturimit. Është përgjegjësi e jona siguri i burimeve të nevojshme për të përmbushur kërkesat e Certifikatës së Fushës së Fluturimit, sigurimin e aftësisë së shërbimit për operimet e zonës ajrore, infrastrukturën, fasilitetet dhe të gjitha pajisjet, për funksionimin e sigurt të Fushës së Fluturimit të Gjirokastër.

Kjo procedurë do tu shpërndahet të gjithë përdoruesve të cilët kanë rol në funksionimin e sigurt të Fushës së Fluturimit.

Ing. Aleksandri Pasha

Menaxher raportues i Fushës së Fluturimit Gjirokastër

0.1.3 Terma dhe përkufizime

Aerodrom - është një zonë e përcaktuar (përfshirë çdo ndërtesë, instalim dhe pajisje), në tokë, mbi ujë, mbi një strukturë fikse në tokë, apo në det, ose mbi një strukturë lundruese, që do të përdoret tërësisht ose pjesërisht për mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen e avionëve mbi sipërfaqe.

Avion me fuqi ultra-i lehtë - është avioni ultra i lehtë, me një peshë maksimale ngritjeje më të ulët se 5700 kg, shtyrja/tërheqja e të cilit në ajër realizohet nga fuqia e një motori.

Fushë fluturimi - është një zonë e përcaktuar, në tokë ose në ujë, e cila plotëson kushtet e nevojshme për nisjen e mbërritjen e avionëve, që përdoren në bujqësi, pylltari, aktivitete sportive dhe kreative.

Certifikatë regjistrimi – Certifikata e regjistrimit e lëshuar nga AAC sipas dispozitave të Rregullores UM nr. 99 datë 14.05.2024, e vlefshme për të operuar një aerodrom.

Menaxheri raportues - është personi i pranuar nga AAC-ja për të kryer funksionet sipas parashikimeve të Rregullores miratuar me UM nr. 99 datë 14.05.2024.

Objektet dhe pajisjet e aerodromit - Objektet dhe pajisjet brenda ose jashtë kufijve të aerodromit që janë ndërtuar ose instaluar dhe mirëmbajtur për mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen e avionëve.

Operator i fushës së fluturimit dhe terrenit - është subjekti të cilit i është lëshuar nga AAC-ja dokumenti i regjistrimit të fushës së fluturimit dhe terrenit.

Pengesë - Të gjitha objektet fikse (qoftë të përkohshme ose të përhershme) dhe objektet e lëvizshme, apo pjesë prej tyre,që:

- a) janë të vendosura në një zonë të caktuar si sipërfaqe për lëvizjen e avionëve; ose
- b) tejkalon mbi një sipërfaqe të përcaktuar për qëllim mbrojtjen e avionëve gjatë fluturimit; ose
- c) qëndron jashtë këtyre sipërfaqeve të përcaktuara dhe është vlerësuar si një rrezik për navigimin ajror.

Pikë referimi e aerodromit – Cakton vendndodhjen gjeografike të një aerodromi.

Pista - Një sipërfaqe e përcaktuar drejtkëndore në një aerodrom në tokë e rregulluar për uljen dhe ngritjen e avionëve.

Rrip piste (strip) - Një zonë e përcaktuar, e cila përfshin gjithashtu pistën dhe zonën e ndalimit nëse është e ndodhur, e cila:

- a) redukton rrezikun e dëmtimit të një avioni që del jashtë një piste; dhe
- b) mbron avionët në fluturim gjatë uljes, ngritjes ose operacioneve në tokë.

Lartësia e aerodromit - Lartësi e pikës më të lartë të zonës së uljes.

Shënues (Marker) - Një objekt i vendosur mbi sipërfaqen e tokës, me qëllim për të treguar një pengesë ose të përcaktojë një kufi.

Shenjë (Markings) - Një simbol ose një grup simbolesh të shfaqura në sipërfaqen e zonës së lëvizjes në mënyrë që të përcjellin informacione aeronautike.

Sipërfaqet e kufizuara të pengesave (OLS) - Një seri planesh/sipërfaqesh të lidhura me çdo pistë në një aerodrom, që përcaktojnë kufijtë e parashikuar, në të cilat objektet mund të projektohen në hapësirën ajrore rreth fushës së fluturimit që operacionet e avionëve në të, të kryhen në mënyrë të sigurt.

Temperatura referencë e Aerodromit- është temperatura maksimale ditore për muajt më të nxehtë të vitit (muaji më i nxehtë është ai muaj që ka mesataren më të lartë mujore).

Transport ajror i përgjithshëm - janë të gjitha operimet e aviacionit civil të ndryshme nga shërbimet ajrore të programuara dhe operimet ajrore jo të programuara për qëllime fitimi ose me qira.

Zona e sigurisë së fundit të pistës (RESA)- Një zonë simetrike në lidhje me zgjatimin e vijës së qendrës së pistës dhe ngjitur me fundin e anëve të pistës e projektuar kryesisht për të reduktuar/eliminuar rrezikun e dëmtimit të një aeroplani që ulet para kohe në pistë ose del jashtë piste.

Zonë e mbrojtur - është përcaktimi i hapësirës ajrore përreth aerodromeve, e cila duhet mbajtur e lirë nga pengesat, duke lejuar që operimet e mjeteve ajrore të kryhen në mënyrë të sigurt, të parandalojnë që aerodromet të bëhen të pashfrytëzueshme nga shtimi i pengesave përreth tyre, si dhe të sigurojnë që projektet zhvillimore të ndërtimit në zonat e përcaktuara, në asnjë formë, të mos shkelin kërkesat e sigurisë së lundrimit ajror dhe të jenë në përputhje me operimet në aerodrom.

0.2 SISTEMI I AMENDIMEVE DHE RISHIKIMEVE

0.2.1 Detaje të personit përgjegjës për pasqyrimin e rishikimeve dhe amendimeve të procedurës. Fusha e fluturimit të Gjirokastrës zotëron të gjithë te drejtat, përfshirë ato në të drejtat e autorit të Procedurës së operimit dhe mirëmbajtjes. Asnjë e drejtë e transferimit, caktimit ose krijimit të aktiviteteve të lidhura të bazuara në këtë procedurë nuk jepet pa lejen me shkrim të Menaxherit Raportues të aerodromit. Cdo ndryshim në këtë procedurë mund të autorizohet vetëm nga Menaxheri Raportues i aerodromit.

Kjo procedurë është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Procedura dhe cdo rishikim i saj, është subjekt i miratimit nga Autoriteti Shqiptar i Aviacionit Civil (AAC).

Fusha e Fluturimit Gjirokastrë

0.2.2 Regjistër i amendimeve dhe rishikimeve

Kjo procedurë duhet të rishikohet për të siguruar konformitetin e saj të vazhdueshëm me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe të gjitha kërkesat që vijnë nga organet dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare që synojnë konformitetin me rregulloren dhe ndryshimet e saj, procedurat dhe paktikat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Më poshtë është paraqitur regjistri i rishikimeve.

Amendimi	Data e amendimit	Autori/Editori	Ndryshime të Amendimit
00			Versioni i parë
01	25.10.2024		Versioni i parë

0.2.3 Lista e faqeve efektive

Pika dhe/ose kapitulli	Faqet nga...- në.....	Amendimi Nr.	Data e amendimit
0.1.3 Terma dhe përkufizime	5-6	01	25.10.2024
2.1 Detyrimet dhe përgjegjësitë e operatorit të fushës së fluturimit	9-9	01	25.10.2024
2.2 Pozicionet e ngarkuara me përgjegjësi për sigurinë në operim dhe detyrat përkatëse.	11-11	01	25.10.2024
C. PROCEDURAT E OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË FUSHËS SË FLUTURIMIT TË GJIROKASTRËS	13-19	01	25.10.2024

0.2.4 Lista e shpërndarjes

Përgjegjës për shpërndarjen	Bashkia Gjirokastrë
Lista e shpërndarjes	Operatorëve që do të operojnë në aerodrom, stafit të aerodromit, Autoritetit të Aviacionit Civil.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1.1 OBJEKTI DHE QËLLIMI I PROCEDURËS

Kjo procedurë përmban të gjithë informacionin e rëndësishëm në lidhje me vendndodhjen e fushës së fluturimit, objektet, shërbimet, pajisjet, procedurat e operimit, inspektimin e aerodromit dhe format përkatëse, shenjat, vijëzimet, si dhe mirëmbajtjen e tij me qëllim mundësimin e funksionimit të sigurt.

1.2 KËRKESAT LIGJORE TË ZBATUESHME

Autoriteti i Aviacionit Civil ka lëshuar një certifikatë regjistrimi për operatorin e aerodromit “Bashkinë Gjirokastër” për të menaxhuar fushën e fluturimit dhe kjo procedurë hartohet në mënyrë të tillë që të përmbushë standardet e zbatueshme, si termat dhe kushtet e përcaktuara në certifikatën e regjistrimit.

Dokumenti “Procedurat e operimit dhe mirëmbajtjes” janë përgatitur në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin e mëposhtëm në fuqi:

- Ligji Nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.
- Urdhri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.99, datë 14.05.2024 “Për Miratimin e Rregullores për Regjistrimin e Fushave të Fluturimit dhe Terreneve në Republikën e Shqipërisë”.

A. ORGANIZIMI DHE PËRGJEGJËSITË E AERODROMIT FUSHOR TË GJIROKASTRËS.

Emri i Operatorit të Aerodromit:

Bashkia Gjirokastrë

Tel: ++355 84 26 4103

Fax: ++355 84 26 3796

Email: ebreshani0@gmail.com

Adresa e Aerodromit:

Gjirokastrë, Shqipëri

Pika e kontaktit:

Aleksandër Pasha

Menaxher raportues i aerodromit

E-mail: ing.aleksander@gmail.com

Tel: +355 68 625 0868

2.1 Detyrimet dhe përgjegjësitë e operatorit të fushës së fluturimit

Operatori i fushës së fluturimit duhet të sigurohet që operimi i saj të kryhet në përputhje me kushtet dhe termat e vendosura në certifikatën e regjistrimit dhe në zbatim të standarteve të aplikueshme për fushat e fluturimit dhe terreneve të regjistruara bazuar në UM 99/2024.

Për më tepër, Operatori i Fushës së Fluturimit “Bashkia Gjirokastrë” do të sigurohet se para zhvillimit të aktiviteteve:

- Menaxheri raportues para cdo aktiviteti kryen një inspektim për gjendjen e shërbimit të fushës së fluturimit dhe terrenit në përputhje me kërkesat e UM 99/2024 A1-1.3.1.

Fusha e Fluturimit Gjirokastër

- Treguesi i drejtimit të erës është sipas kërkesave në UM 99/2024 A2-11.
- Mjeti për emergjenca dhe mjeti zjarrëfikës të jenë në gadishmëri në përputhje me UM 99/2024 A1-1.1.9 dhe A1-1.8.
- Lartësia e barit për sipërfaqen e pistës dhe brezit të gjelbër të pistës të jetë në përputhje me UM 99/2024 A2-5 Sipërfaqja e Pistës.
- Marrjen e të dhënave meteorologjike nga Shërbimi Meteorologjik Ushtarak dhe vënia në dijeni pilotit.
- Të realizojë inspektimet e sigurisë sipas kërkesave të UM 99/2024 Neni 10.
- Të realizojë inspektimet e gjendjes së shërbimit të fushës së fluturimit dhe terrenit sipas kërkesave të UM 99/2024 pika A1 – 1.2 si dhe duke përdorur formën bashkëlidhur kësaj procedure.
- Në cdo rast kur fusha e fluturimit është jo operativ, menaxheri raportues të sigurohet se janë vendosur sinjalet tokësore të mosfunksionimit dhe të njoftojë operatorët ajrorë që operojnë aty në përputhje me UM 99/2024 A1-1.7.4.
- Është detyrim i operatorit të fushës së fluturimit të identifikojë nëse ka pengesa brënda hartës me sipërfaqe me kufizim pengesash të dorëzuar, dhe në rast se ka, ti markojë ato dhe të njoftojë AAC-në në zbatim të UM 99/2024 A2-13 dhe A2-14.

Gjithashtu, është përgjegjësi e operatorit të fushës së fluturimit të regjistruar të mirëmbajë aerodromin dhe fasilitetet me qëllim garantimin e sigurisë në operim.

Mirëmbajtja e fushës së fluturimit, gjatësia e barit, gradimi i pistës dhe zonave të sigurisë, gjendja e shenjave dhe vijëzimeve, treguesi i drejtimit të erës, gardhi dhe fasilitetet e tjera të aerodromit do të sigurohet nga departamenti përkatës i mirëmbajtjes në Bashkinë Gjirokastër. Mirëmbajtja do të kryhet periodike dhe gjithashtu dhe sipas kërkesës, nga vlerësimi që do i bëhet infrastrukturës dhe faciliteteve nga menaxheri raportues.

Shumë punë të mirëmbajtjes përfshijnë punë të vogla afatshkurtra si lyerja, zëvendësimet periodike të planifikuara (p.sh. pastrimi i barit, gardhit etj në përputhje me një plan të mirëmbajtjes parandaluese), përmirësime të sistemeve/infrastrukturës dhe riparime të vogla në infrastrukturën e aerodromit (gradimi i pistës dhe zonave të sigurisë), të cilat mund të përfundojnë në afate të shkurtra dhe me pengesa të kufizuara në punë. Punët e vogla të planifikuara ose rutinë të mirëmbajtjes nuk kanë nevojë të njoftohen në AAC, megjithëse duhet të ruhen rekordet përkatëse të cilat duhet t'i vihen në dispozicion AAC-së gjatë inspektimeve/auditeve ose/dhe sipas kërkesës.

Marrëveshjet e tjera që Fusha e Fluturimit “GJIROKASTRA” duhet të lidhë janë:

Fusha e Fluturimit Gjirokastër

- Marrëveshje me Shërbimin e Shpëtimit dhe Zjarrëfikjes lokale, për sigurimin e prezencës së një automjeti në cdo kohë kur ka operim (Stand by) sipas UM 99/2024 pika A1-1.8.
- Marrëveshje me Shërbimin Shëndetësor lokal për të garantuar prezencën e ambulancës në cdo kohë kur ka operim sipas UM 99/2024 pika A1-1.1.9.

2.2 Pozicionet e ngarkuara me përgjegjësi për sigurinë në operim dhe detyrat përkatëse.

Operatori i fushës së fluturimit të regjistruar duhet të emërojë një ose më shumë menaxherë raportues për fushën e fluturimit.

Detyrat e menaxherit raportues janë:

1. Të monitorojë ofrimin e shërbimeve të aerodromit në përputhje me standardet e Rregullores UM 99/2024;
2. Duhet të organizojë kryerjen, të paktën një herë në vit, të një inspektimi sigurie të fushës së fluturimit;
3. Duhet t'i japë operatorit një raport me shkrim ku të specifikojë çdo punë riparuese/mirëmbajtjeje që është e nevojshme për aerodromin në përputhje me standardet e aplikueshme.
4. Të ruajë evidenca të inspektimeve që kryen, të mbajë regjistrin e inspektimeve të mirëmbajtjes që i bëhen aerodromit dhe fasiliteve përkatëse për një periudhë 24 mujore.
5. Të verifikojë para cdo operimi gjendjen e shenjave, vijëzimeve dhe infrastrukturës së aerodromit duke garantuar se ato mundësojnë operimin e sigurtë.

Menaxheri përgjegjës	Ushtruesi aktual i funksionit
Menaxher raportues për Fushën e fluturimit të Gjirokastrës	Ing. Aleksandri Pesha

B. VECORITË E ZONËS SË FLUTURIMIT

3. PËRSHKRIMI I FUSHËS SË FLUTURIMIT

3.1 PLANI I CILI PARAQET DISTANCËN E FUSHËS SË FLUTURIMIT NGA QYTETI APO ZONA MË E AFËRT E POPULLUAR

Qyteti më pranë fushës së fluturimit të Gjirokastrës është qyteti i Gjirokastrës.

Fusha e Fluturimit Gjirokastër

3.2 KUSHTET E PËRDORIMIT TË FUSHËS SË FLUTURIMIT TË GJIROKASTRËS

Fusha e Fluturimit Gjirokastër do të përdoret për fluturime nga avionë me peshë maksimale të ngritjes që nuk i kalojnë 5700 kg, për fluturime kombëtare vetëm VFR duke respektuar kushtet e mira meteorologjike (VMC), nga lindja deri në perëndim të diellit, për qëllime private dhe sportive.

3.3 PËRSHKRIMI I KARAKTERISTIKAVE FIZIKE TË FUSHËS SË FLUTURIMIT

A. Pika e referimit të aerodromit (WGS-84): ARP – 400 05' 21" N, 200 09' 02" E-Midpoint of RWY – 14/32

B. Kodi i referencës së fushës së fluturimit: 1B

C. Karakteristika Fizike

Identifikimi i pistës <i>Runway designator</i>	Gjatësi, Gjerësi <i>Longitude, Latitude</i>
14	1000 x 40
32	1000 x 40

Sipërfaqja e pistës është prej bari ose dheu dhe e niveluar/trajtuar me makinë nivelimi.

D. Kushtet e autorizuara të operimit

Ditën/Day PO / YES	Identifikimi i pistës Runway designator	Lloji i afrimit Approach type	LVO / LVTO
Natën/ Night JO / NO	14	VFR (visual flights rules) VMC (visual meteorological conditions)	NIL
IFR – JO / NO	32	VFR (visual flights rules) VMC (visual meteorological conditions)	NIL
VFR - PO / YES			
Kategoria e aerodromit për shërbimet e shpëtimit dhe fikjes së zjarrit Category of aerodrome for rescue and firefighting services 1 mjet zjarrfikës dhe 1 mjet për emergjenca / 1 rescue and firefighting vehicle and 1 emergency vehicle			

E. Kufizimet në operim: Avionë me 9 ose më pak vende pasagjerësh

Fusha e fluturimit është e pajisur për të kryer fluturime në kushte dukshmërie (VMC)

Fluturimi në Fushën e fluturimit kërkon:

Dukshmëria horizontale të paktën..... 8 km

Lartësia e bazës së poshtme të reve të paktën.....450. m.QFE

Distanca vertikale nga baza e reve:.....200 m

Largësia horizontale nga retë:1500 m

Shpejtësia maksimale e erës:..... 10 m/s

Shpejtësia maksimale e erës së komponentëve anësore, kokës dhe bishtit varet individualisht nga lloji i avionit dhe në këtë mënyrë siguron informacion për shpejtësinë dhe drejtimin e erës tek aeroplanët që planifikojnë ngritje dhe ulje. Pilotët e avionëve janë të detyruar të dinë karakteristikat e avionit me të cilin fluturojnë dhe në përputhje me rrethanat, pas marrjes së informacionit, të vendosin nëse do të vazhdojnë uljen apo ngritjen.

C. PROCEDURAT E OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË FUSHËS SË FLUTURIMIT TË GJIROKASTRËS

4.1. Inspektimi i infrastrukturës dhe faciliteteve të fushës së fluturimit

Menaxheri raportues i fushës së fluturimit, duhet të kryejë para cdo aktiviteti të planifikuar inspektimin e infrastrukturës dhe faciliteteve të aerodromit, në përputhje me Checklistën e Shtojcës 1 të kësaj procedure, duke u fokusuar në fushat e mëposhtme:

- Verifikimin e shenjave dhe vijëzimeve, duke u siguruar që janë në përputhje me kërkesat e UM 99/2024;
- Verifikimin e gjendjes së treguesit të drejtimit të erës, dukshmëria e tij dhe pozicionimi i saktë;
- Verifikimin e pistës lidhur me nivelimin;
- Verifikimin e gjatësisë së barit, duke u siguruar që është në përputhje me kërkesat e UM 99/2024, si për pistën ashtu dhe për zonat e sigurisë;
- Të sigurohet që nuk ka objekte të huaja në të gjitha zonat e lëvizjes;
- Të sigurohet që nuk ka aktivitete të botës shtazore para cdo fluturimi të planifikuar.
- Të verifikojë gjendjen e gardhit rrethues duke u siguruar që është në gjendje të përshtatshme, si barrierë mbrojtje për të mos lejuar aksesimin e personave të paautorizuar dhe hyrjen e botës shtazore në zonën e operimit.
- Verifikimi i gjendjes së kanaleve të kullimit.

Cdo problematikë e evidentuar, duhet të shënohen në checklistë dhe të merrën masa për përmirësimin e saj para cdo fluturimi.

Menaxheri raportues është personi i kontaktit për koordinimin e vazhdueshëm lidhur me zhvillimin e aktiviteteve në fushën e fluturimit të Gjirokastrës.

Inspektive shtesë mbi gjendjen e infrastrukturës dhe fasiliteve do të kryhen pas fenomeneve të rëndësishme të motit, si psh erërat e forta ose shira të rrëmbueshëm sipas UM 99/2024 A1-1.3.2.

4.2. Mirëmbajtja

Në cdo rast kur identifikohen problematika lidhur me gjendjen e infrastrukturës dhe/ose fasiliteve të aerodromit, departamenti përgjegjës për mirëmbajtjen duhet të marrë masa të menjëhershme për korrigjimin e tyre:

- Në rast se ka problematika të nivelimit të pistës ose zonave të sigurisë duhet që të merren masa për të garantuar nivelimin e tyre para cdo fluturimi;
- Kur shenjat ose vijëzimet nuk janë të dukshme, duhet të merren masa për zëvendësimin ose ri lyerjen e tyre me qëllim garantimin e dukshmërisë;
- Riparime të gardhit në rast problematikash;
- Treguesi i drejtimit të erës duhet të verifikohet lidhur me gjendjen e tij dhe të kryhen riparime/zëvendësime të copës me qëllim dukshmërinë, sa herë të jetë e nevojshme;
- Mirëmbajtja e gjatësisë së barit në përputhje me kërkesat e UM 99/2024;
- Mirëmbajtja e kanaleve të kullimit;
- Heqja manuale e barërave të këqija dhe bimëve gjemba;
- Shkatërrimi i brejtësve duke përdorur agjentë kimikë;
- Prerja e bimëve dhe pemëve që tejkalojnë lartësinë e lejuar në pjesën afruese të zones;

4.3. Procedura për njoftimin e AAC-së për të gjitha ndryshimet dhe regjistrimet e njoftimeve për ndryshime gjatë dhe jashtë orarit normal të operatorit të fushës së fluturimit:

Për të gjitha ndryshime te përkohshme apo të përhershme në gjendjen fizike të fushës së fluturimit të Gjirokastrës, menaxheri përgjegjës duhet të njoftojë pilotët që operojnë në këtë fushë, kontrollin e trafikut ajror shqiptar dhe Autoritetin e Aviacionit Civil.

Këto ndryshime konsistojnë në:

- mbyllje ose ndryshime të rëndësishme në funksionimin e fushës së fluturimit;
- punët e planifikuara të një shtrirjeje më të madhe;
- shfaqja dhe devijimi i keqfunksionimeve ose pengesave të mëdha në sipërfaqet e manovrimit.

4.4. Procedurat për lëvizjen, parkimin e mjeteve, dhe aksesimin e zonës së lëvizjes:

a) Vizitorët ose automjetet që hyjnë në zonën e operimit duhet të respektojnë udhëzimet e menaxherit raportues përgjegjës.

Hyrja në afushën e fluturimit duhet të mbrohet nga një barrierë në hyrje. Në këtë mënyrë pengohet qasja tek vizitorët dhe automjetet pa lejen e menaxherit përgjegjës.

b) Lëvizja e njerëzve

Vizitorët në afushën e fluturimit “Gjirokastra” lejohen të lëvizin vetëm me lejen e personit të autorizuar.

c) Parkimi i mjeteve

Të gjitha mjetet, përveç mjeteve të destinuara për lëvizje në zonat e manovrimit ose autoambulancat, parkohen pas hyrjes së aerodromit në vendin e shënuar për këtë qëllim.

4.5. Plani i emergjencave në aerodrome

Plan operimi emergjent në ose afër fushës së fluturimit, duke përfshirë mosfunksionimin e avionit gjatë fluturimit, zjarrin në vend, sabotimin, kërcënimet me bombë, posedimin e paligjshëm të avionëve dhe incidentet e avionit në kushte emergjente dhe pas emergjence, do të përfshijë sa më poshtë:

Në rast emergjence në fushën e fluturimit GJIROKASTËR dhe pas marrjes së informacionit, do të merren **masa të menjëhershme** për shmangien e pasojave të saj duke kontaktuar shërbimet kompetente të qytetit të GJIROKASTËS (shërbimi zjarrfikës, ndihma emergjente, Ministria e Brendshme dhe të gjitha shërbimet që do të prekeshin nga situata e re), duke njoftuar AAC-në, Kontrollin e Trafikut Ajror, si dhe duke njoftuar me radiokomunikim avionët që mund të ndodhen në ajër.

Nëse është e nevojshme, një aerodrom alternativ ndaj fushës së fluturimit të Gjirokastrës është Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, Nënë Tereza.

Pezullimi i fluturimeve në fushën e fluturimit të GJIROKASTRËS kryhet me urdhër të kontrollorit të trafikut ajror kur kërcënohen kushtet për aktivitete të mëtejshme fluturimi.

Ndërprerja e fluturimit kryhet me anë të radiolidhjes ose me vendosjen e sinjaleve dhe tabelave të caktuara në tokë.

4.6. Shpëtimi dhe mbrojtja nga zjarri

Mbrojtje nga zjarri

Në rast organizimi të shfaqjeve ajrore si dhe në ngjarje të jashtëzakonshme, kërkohet ndihmë nga MZSH e qytetit të GJIROKASTRËS, të cilët do të jenë stand by gjatë cdo aktiviteti të organizuar.

Në rast zjarri, roja njofton me telefon shërbimin zjarrfikës të qytetit të GJIROKASTRËS për situatën e re dhe më pas njofton menaxherin e aerodromit fushor GJIROKASTËR nëse nuk është i pranishëm në fushën e fluturimit.

Personi përgjegjës për mbrojtjen nga zjarri është menaxheri raportues.

Parandalimi i zjarrit

- Të gjithë personat e pranishëm në fushën e fluturimit janë të detyruar të parandalojnë zjarrin.
- Të gjithë personat e pranishëm, duhet t'u binden shenjave të vendosura për ndalimin e pirjes së duhanit ose zjarrit.
- Mbetjet nuk duhet të ruhen në ose pranë ndonjë ndërtese ose automjeti, përveç në një kontejner ose fuçi të destinuar për atë përdorim.
- Mbetjet yndyrore, pëlkurat dhe substancat e tjera të ndezshme duhet të ruhen në një fuçi të veçantë, e cila pas hedhjes së mbeturinave mbyllet dhe largohet nga fusha e fluturimit në një interval kohor të caktuar në mënyrën e kërkuar nga rregulloret për ruajtjen e mjedisit.
- Pastrimi i pjesëve të avionit kryhet kur është e mundur me lëngje jo të ndezshme. Nëse kjo nuk është e mundur, pastrimi bëhet në një zonë të hapur me pajisje adekuate dhe të përshtatshme për shuarjen e zjarrit dhe në një mënyrë të përcaktuar nga ligjet e kontrollit të ndotjes.
- Ndalohet mbajtja e lëngjeve të ndezshme në bagazhet e avionëve.
- Kontejnerët bosh me vaj, bojëra, kanaçe dhe shishe duhet të hiqen menjëherë, në mënyrë që të mos mbeten në dyshe, raft, tavolinë ose pranë ndonjë avioni.
- Ndalohet puna me mjete (bluarje, saldim, vegla që prodhojnë shkëndija) pranë bombolave të karburantit ose substancave të ndezshme ose pranë vetë avionit.
- Deri në çfarë mase ka nevojë për punime saldimi në një mjedis ku ka rreziqe zjarri, është e nevojshme të merren të gjitha masat e nevojshme për parandalimin e shfaqjes së zjarrit, si dhe prania e një eksperti zjarrfikës me pajisjet e nevojshme dhe agjent shuarës.
- Kërkohet inspektimi i rregullt i pajisjeve elektrike, instalimit dhe pajisjeve edhe në objektet e tjera në aerodrom.
- Në periudhën e verës, zona me bar mirëmbahet rregullisht dhe me këtë nuk lejohet kalimi i zjarrit nga zonat ngjitur me bar.

4.7. Inspektimi i mjeteve në zonë të kontrolluar

Mjeti duhet të lëvizë me shpejtësi të sigurt, me përjashtim të rasteve kur është e nevojshme për të shmangur një përplasje ose për të dalë shpejt nga pista. Automjeti mund të drejtohet vetëm nga një person me patentë shoferi të vlefshëm. Ndalohet drejtimi i mjetit ose i çdo pajisjeje të mekanizuar në rast se drejtuesi i mjetit është nën ndikimin e alkoolit ose të ndonjë droge dehëse. Mund të ketë po aq pasagjerë në automjet sa ka ndenjësë të caktuara në automjet. Ndalohet drejtimi i shumë pasagjerëve ose drejtimi i pasagjerëve jashtë kabinës së automjetit.

Gjatë ulje/ngritjes së avionëve, ndaloht lëvizja e mjeteve në pistë.

Në rast të uljes së detyruar të një avioni, mjeti sinjalizohet duke gjuajtur një raketë të kuqe dhe duke valëvitur një flamur të kuq.

Detyrat për të cilat automjeti mund të dërgohet në zonat e përmendura janë si më poshtë:

- inspektimi i pistës
- transportimi i ekuipazhit në pozicionin e fillimit
- transportin e pajisjeve të zjarifikësve
- nivelimi i pistës dhe zonave të manovrimit
- kositja dhe depozitimi i barit dhe mbetjeve nga pista dhe zonat e manovrimit

4.8. Procedurat e kontrollit të pengesave

a) Monitorimi i sipërfaqes për të kufizuar pengesat kryhet çdo ditë në lidhje me inspektimin e zonës.

b) Personi përgjegjës monitoron dhe evidenton rregullisht gjendjen e pengesave në zonën e hyrjes, informon menaxherin dhe në përputhje me rrethanat merren masa për heqjen e tyre. UM 99/2024 A2-13. Personi përgjegjës për monitorimin e pengesave është menaxheri raportues i fushës së fluturimit.

c) mbikëqyrja e lartësisë së objekteve ose strukturave në përputhje me kufijtë dhe sipërfaqet për të kufizuar pengesat.

Mbikëqyrja e lartësisë së ndërtesave kryhet çdo ditë nga personi përgjegjës për kontrollin e zonës.

Në rast se vërehen ndryshime, njoftohet menaxheri i fushës së fluturimit GJIROKASTRA, i cili njofton me shkrim AAC-në.

d) kontrolli i zhvillimeve të reja pranë fushës së fluturimit.

Nëse në afërsi të fushës së fluturimit kryhen ndërtime, gjurmime ose aktivitete të tjera, menaxheri duhet të njoftojë me shkrim AAC-në.

e) raportimi në AAC për natyrën dhe vendndodhjen e pengesave, çdo veprim të ndërmarrë për heqjen e tyre, duke përfshirë publikimin në publikimet e AIS.

Në rast se ka ndryshime të pengesave apo ndërtimeve të objekteve që nuk përputhen me rregullat e sigurisë të fushës së fluturimit të GJIROKASTRËS, personi përgjegjës (menaxheri) njofton AAC-në me anë të një shkrese.

4.9. Trajtimi i materialeve të rrezikshme

- a) përcaktimi i zonave të veçanta të aerodromit që do të destinohen për ruajtjen e substancave të ndezshme (përfshirë karburantin për avionët);
- b) mënyrën e dorëzimit, ruajtjes dhe mbushjes së karburantit në avion.

Shtojca 1 – Checkista për inspektimin e zonës së lëvizjes

Ref.Nr.	Fusha që inspektohet	Gjetje		Shënime	Veprime korrigjuese
		JO	PO		
1.	Perimetri rrethues -Kontrollo për dëmtime ose shenja të tentativave për të hyrë nga njerëz/bota shtazore. UM 99/2024 A2-12				
2. Inspektimi i pistës dhe zonave të sigurisë (RESA/STRIP)					
2.1	FOD -Kontrollo nëse ka objekte të huaja në të gjithë gjatësinë e pistës. UM99/2024 A1-1.2.3				
2.2	Nivelimi i pistës -Verifiko duke lëvizur me një mjet të rënë nivelimin e pistës në të gjithë gjatësinë e saj. UM99/2024 A2-5				
2.3	Lartësia e barit -Verifiko nëse lartësia e barit për pistën dhe rripin e pistës është në përputhje me kërkesat e UM 99/2024 A2-5.				
2.4	Shenjat e pistës -Verifiko pragjet e pistës a janë të lypa në përputhje me kërkesat e paragrafit A2-10.1 të UM 99/2024 Fundet e pistës, vijëzim me bojë të njëjtë në kënd të drejtë				
2.5	Shenjat e pistës -Verifiko shenjat anësore të pistës të cilat duhet të kenë gjerësi 0.3 m dhe të lypa në të bardhë.				

	-Përmasat e shënjesve: diametër baze prej 0.4 m dhe lartësi 0.3 m				
2.6	Shenjat e rripit të pistës (strip) -Verifiko nëse rripi i pistës është i shenjuar me shenja në formë konike, me majë, goma ose tambure prej 200 litra të prera në gjysëm përgjatë gjatësisë së tyre dhe të vendosura në pjesën e hapur poshtë. Shënjesit duhet të jenë me ngjyrë të bardhë. -Përmasat e shënjesve në formë konike: diametër baze prej 0.75 m dhe lartësi 0.5 m -Shenjat me majë duhet të jenë 3 m të larta. Distanca: 90 m për shënjesit në formë konike dhe 180 m për shënjesit me majë.				
3. Treguesi i drejtimit të erës					
3.1	Forma -mëngë pëlhure në formë konike 3.65 m i gjatë dhe me ngjyrë të bardhë.				
3.2	Vendosja -duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të jetë i dallueshëm nga ajri. Duhet të vendoset larg pemëve , godinave apo zonave të tjera, që të mos impaktohet funksionimi i tij.				
3.3	Verifiko gjendjen e copës dhe dukshmërinë e ngjyrave.				
4. Kanalet e kullimit					
4.1	Gjendja e kanaleve të kullimit. Të pastruara, pa mbetje				
5. Bota shtazore					
5.1	Prezenca e botës shtazore në ose në afërsi të fushës së fluturimit.				
6. Kontrolli i pengesave					
6.1	Verifiko zonat rrotull fushës së fluturimit për prezencën e pengesave.				